

V E N D I M
Nr. 392, datë 12.8.1999

**PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT TË VEÇANTË MONETAR, TË KRIJUAR SIPAS LIGJIT
NR. 7598, DATË 1.9.1992 “PËR ISH-TË DËNUARIT DHE ISH-TË PËRNDJEKURIT
POLITIKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5 të ligjit nr. 8246, datë 1.10.1997 “Për Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Për plotësimin e kërkesave me karakter emergjent të ish-të dënuarve dhe ish-të përndjekurve politikë, fondi i veçantë monetar, i krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 1.9.1992, të administrohet nga Instituti i Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë, sipas kriterëve të mëposhtme:

a) 50 për qind e këtij fondi për të ndihmuar, ekonomikisht e materialisht, familjet e përndjekura, për nevoja urgjente, për integrimin e tyre shoqëror;

b) 50 për qind për të financuar shoqatat e ish-të përndjekurve politikë. Financimi i shoqatave të veçanta do të bëhet në përpjestim me numrin e anëtarëve të tyre.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 26.10.1993 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko